



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.13/2018

Prishtinë, më 30.1.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuara: Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Fidaim Sahiti, Fazile Bekteshi, Skender Sallahi dhe Hysen Komoni–MZHE; Amir Kozmaqi, INDEP, Agnesa Haxhiu, KDI dhe Agon Sinanaj, “Zëri”.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.1.2018;
- 3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale;
- 4.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion;
- 5.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
- 6.Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.07/21 datë 22.12.2017 lidhur më Ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067”;
- 7.Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hap mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Hykmete Bajrami propozoi që të shtohet dhe një pikë e re në rendin e ditës, si pika e fundit, “Shqyrtimi i Raportit më Amendamente i Projektligjit nr.06/-016 për Shoqëritë Tregtare”, pasi që grupi i punës e ka përfunduar punën dhe amendamentet tanimë ua kemi proceduar, dhe propozimi i miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.1.2018

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 23.1.2017, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale

Sala Berisha-Shala, kryetare, tha se siç e dini Projektligji për Miniera dhe Minerale është nismë e inja legjislative dhe e mbeshetur nga komisioni. Pastaj paraqiti ekspozenë shqyrtimit të procedurave si vijon: Më 24.10.2017, me propozim të kryetares, komisioni mori vendim për të hartuar Nismën legjislative “Projektligji për Miniera dhe Minerale”; më 7.11.2017, grupi i punës mbajti takimin konstituiv, ndërsa më 9.11.2017, grupi i punës u takua edhe me institucione ligjzbatuese për t’i përfshirë në grup pune; më 15-16.11.2017, grupi i punës mbajti punëtori të organizuar nga OJQ INDEP, ku morën pjesë të gjitha palët e përfshira në këtë proces; më 30.11.2017, komisioni e miratoi raportin e grupit të punës dhe e procedoi tutje sipas procedurës për mendim në Qeveri; më 15.1.2018, Qeveria ktheu mendimin e saj lidhur më këtë nismë legjislative. Tani jemi në fazën kur nisma e komisionit ka marrë formën e projektligjit dhe i nënshtrohet shqyrtimit të bazë të Rregullores së Kuvendit. Sot, si Komision Funkcional e shqyrtojmë në parim dhe e procedojmë tutje për lexim të parë në Kuvend. Ndërsa, në emër të Qeverisë për ta paraqitur mendimin ia dha fjalën zëvendësministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, z. Xhavit Zariqi.

Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Rregulloren për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive mbështet iniciativën e ndërmarrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjegjësisht Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik. Projektligji në përgjithësi në aspektin normativ ka rregulluar fusha të caktuara që ka vlerësuar me rëndësi për proceset që parashihen edhe me Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës 2012-2025. Çështje kryesore e trajtuar dhe propozuar nga MZHE, në këtë Projektligj është rishikimi i Nenit 18, paragrafi 4 i Projektligjit.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

1. Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale.

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion

Kryetarja tha se ky projektligj është proceduar nga Qeveria në Kuvend për shqyrtim, ku për ta paraqitur në parim ia dha fjalën zëvendësministrit, z. Xhavit Zariqi.

Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se ky Projektligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore që mundësojnë garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion, si dhe kushtet dhe kërkesat themelore të sigurisë që duhet të respektohen nga operatorët ekonomik që prodhojnë, administrojnë apo shfrytëzojnë enët e thjeshta nën presion, pajisjet nën presion, pajisjet transportuese nën presion apo aerosolët. Ky Projektligj përfshin kushtet dhe kërkesat themelore të sigurisë që duhet të zbatohen për projektim, prodhim, vlerësim të konformitetit, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe instalimeve nën presion që i nënshtrohen një presioni punues manometrik të lejuar më të lartë se 0.5 bar. Projektligji është në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së për pajisjet nën presion, dhe përmbush kërkesat kryesore të këtyre akteve. Pjesa tjetër e zbatueshmërisë, mbetet të përfundohet me nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse nga ana e ministrisë.

Pas debatit, komisioni unanimitet nxori këtë:

Përfundim

- 1. Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.*

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetarja, i njoftoi anëtarët e Komisionit që Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës që është në fuqi ka qenë nisme e imja e mbështetur dhe hartuar nga komisioni, dhe tha që po më vjen mirë që e ka pasur efektin e vet në zbatim, dhe ia kaloi fjalën zëvendësministrit, z. Xhavit Zariqi, për ta paraqitur në parim projektligji para komisionit.

Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se çështjet kryesore të trajtuara në këtë Projektligj, janë aktivitetet që përfshinë hulumtimet, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së hulumtimeve gjeologjike, programimin dhe organizimin e hulumtimeve gjeologjike me interes për Republikën e Kosovës. Objektivat dhe ndërlidhja e tyre me prioritetet e Qeverisë janë Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025; Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe Institucionale në fushën e sektorit minerar, si dhe Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare të Kosovës për periudhën 2015-2017. Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqje të investimeve, hulumtimi i Resurseve Minerale dhe raportimi i tyre, si dhe kompletimi i informacioneve të reja për gjendjen aktuale gjeologjike, gjeomjedisore dhe gjeoturistike të zonës, si dhe për gjeoresurset të reja që mund të zbulohen. Elementet kryesore të politikës së propozuar, është funksionalizimi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës si organ këshillimor, teknik

dhe shkencor i shtetit, i cili kryen veprimtari në fushën e shkencave gjeologjike në territorin e Republikës së Kosovës, i cili: bënë hulumtime themelore gjeologjike, hulumtime aplikative gjeologjike të rëndësishme për Republikën e Kosovës. Dispozitat e Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, nuk janë të rregulluara specifikisht me legjislacionin të BE-së, dhe si e tillë, kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së. Konsiderojmë që dispozitat e këtij Projektligji nuk cenojnë parimet themelore të legjislacionit të BE-së.

Dardan Sejdiu pyeti a ka ndonjë rregullore se si kompensohet Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, për shërbimet që i afron për sektorin privat dhe sa të hyra janë nga sektori privat dhe nga ai publik, a keni ndonjë përqindje për të hyrat dhe mjetet që i realizon SHGJK-ja ?

Fidaim Sahiti –MZHE theksoi se nuk ka ekzistuar deri me tani ndonjë rregullore për afrimin shërbimeve gjeologjike, dhe tani më Projektligjin e tanishëm është rregullorja që e parasheh afrimin e shërbimeve gjeologjike për komunat dhe sektorin privat.

Pas debatit, komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.*

6. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr. 07/21 më 22.12.2017 lidhur më Ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067

Kryetarja tha që tani është mirë që ekziston vullneti i të gjithëve që një aseti siç është Pallati i Rinisë dhe sporteve, që t’i hapet rrugë për zhvillim. Siç e dini ndërmarrjet ndahen në shoqërore dhe publike. Ndërsa, “Vendimi i Qeverisë nr. 07/21 më 22.12.2017 lidhur më ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN067”, nuk është i qartë më nenin 4 të Ligjit për ndërmarrjet publike. Mendoj se duhet të kishim edhe një opinion nga Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe të sqarohet ligjshmeria e këtij propozim vendimi. Andaj, për t’i hequr dilemat na duhet një opinion ligjor se a është vendimi i drejtë, dhe a janë respektuar gjitha procedurat. Tha se në krejt lëndën që kemi është vetëm vendimi dhe letra e kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. Propozoi që të shtyhet kjo pikë për një takim të radhës, derisa të kompletohet dokumentacioni.

Dardan Sejdiu tha që neni 4 i Ligjit për ndërmarrjet publike është i qartë, këtë Propozim – Vendim Qeveria ia ka përcjellë Kuvendit për miratim duke i respektuar të gjitha procedurat. Së pari Komuna e Prishtinës, më koordinim më Agjencinë Kosovare të Privatizimit kanë filluar procedurat, lidhur më ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë” për kalimin e saj nga ndërmarrja shoqërore, në ndërmarrje komunale që është duke u menaxhuar nga AKP-ja, dhe kalimin e saj në pronësi të Komunës së Prishtinës. Andaj, gjitha këto procedura janë bërë më bashkë-koordinim më AKP-ën. Siç e dimë kjo ndërmarrje

operon më borxhe të mëdha dhe tani kemi zotimin e Komisionit Evropian, që do të investojë në këtë ndërmarrje nëse definohet pronësia. Propozoi që të procedohet ky Vendim për Kuvend për miratim.

Mimoza Kusari-Lila tha që parimisht pajtohet që ndërmarrja “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë” të kalojë në pronësi si ndërmarrje komunale e Prishtinës. Por, dy gjera kisha dashur sqarim, këtij materiali para deputetëve të komisionit i mungon Vendimi i Kuvendit Komunal të Prishtinës, mandej a ka shpallë interesi i veçantë sepse në aspektin procedural duhet shpallet interesi i veçantë për t’u tërhequr nga lista e privatizimit, gjegjësisht për me u procesuar më tutje; a ka kaluar nëpër procedurë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, edhe ai vendim mungon, është dashtë të jetë e kompletuar në raport me heqjen e dyshimit procedurale apo ligjore.

Dardan Sejdiu theksoi sa i përket aspektit ligjor Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës dhe Zyra Ligjore e AKP-së, janë koordinuar dhe më Zyrën Ligjore të Qeverisë - ZKM-së, dhe e kemi këtë vendimin, me procedurë gjitha obligimet kanë përfunduar në përputhje më ligjin.

Bilall Sherifi tha se në parim nuk kemi kundërshtim që ndërmarrja “Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike Pallati i Rinisë” të kalojë në ndërmarrje publike lokale të Komunës së Prishtinës. Propozoi, që ka mundësi të ftohen në komision, përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës dhe të AKP-së, ta sqarojnë vendimin në aspektin ligjor se si janë pajtuar së kush do ta administrojë Pallatin e Rinisë.

Kryetarja theksoi së pajtohet që t’i jepet epilog kësaj çështje, por është mirë që të presim derisa të sjellin materialin palët që kanë qenë të përfshira në këtë proces dhe mandej e procedojmë tutje, s’kemi nevojë të ngutemi.

Hykmete Bajrami tha se kjo iniciativë është bërë në kohën e ish - kryeministrit z. Isa Mustafa, më bashkëpunim më Bordin e AKP-së, dhe çdo gjë ka qenë në rregull nga të dyja palët. Ne, si komision, kemi mundësi me dërguar në Kuvend, dhe derisa të hyjë për rend ditë në seancë plenare të kërkohet nga palët përfshira në këtë proces t’i dërgojnë vendimet në mënyrë që kompletohet lënda.

Dardan Molliqaj tha se sot ne mund ta procedojmë në Kuvend këtë vendim, pastaj, derisa të futet për miratim në seancë plenare le të kërkohen dokumentacion shtesë nga Qeveria, andaj, komisioni nuk duhet më penguar për mos dërgim.

Mimoza Kusari-Lila propozoi që kjo pikë të shtyhet për miratim, deri të premtën, derisa të kompletohet materiali, sepse të premtën më 2.2.2018. kemi edhe takim prej orës 10, ndërsa, ne e shqyrtojmë para takimit.

Dardan Sejdiu potencoi që janë në pyetje 33 milionë euro që parashihen të investohen nga fondi i Komisionit Evropian për Pallatin e Rinisë, dhe tani e kemi një mundësi të mirë të ecim përpara. Janë dokumentet që ekzistojnë, andaj qytetarët e Prishtinës që 18 vjet kanë pritur t’ju kthehet Pallati i Rinisë që kanë investuar vetë. Prandaj kërkoi që të dërgohet për miratim sepse nëse vonohemi gjatë këtij viti ekziston rreziku që mund t’i humbim fondet për investim.

Kryetarja, në fund, tha se ne kemi një mocion procedural nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, që të shtyhet kjo pikë për 2.2.2018, për t'u pajisur me dokumentacion shtesë nga institucionet përkatëse, dhe hodhi në votim mocionin.

Më 4 (katër) për, dhe 2 (dy) abstenim, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shtyhet për shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.07/21 datë 22.12.2017 lidhur më Ndërmarrjen “Qendra shoqërore, sportive, kulturore dhe ekonomike Pallati i Rinisë – PRN06, për datën 2.2.2018, derisa të kompletohet materiali për këtë çështje.

7. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare

Kryetarja ia dha fjalën znj. Hykmete Bajrami, si kryesuese e grupit të punës ta paraqesë para komisionit raportin me amendamente.

Hykmete Bajrami, në lidhje me raportin me amendamente të Projektligjit për Shoqëritë Tregtare, tha se pas miratimit në parim nga Kuvendi, grupi i punës më 12.12.2017, pranoi një amendament nga deputetja Mimoza Kusari – Lila, më 13.12.2017, pranoi një grup amendamentesh nga deputeti Korab Sejdiu. Komisioni ka pranuar komente nga Oda Ekonomike Amerikane më 17.11.2017 dhe nga Shoqata e Bankave më 9.11.2017. Më kërkesën time, koordinatori i Komisionit më 6.12.2017 ka kërkuar nga odat dhe shoqatat e bizneseve që në një afat një javor të dërgojnë komente më shkrim – asnjë koment nuk kemi pranuar nga ato. Grupi i punës u mbledh më 15.12.2017; 19.1.2018 dhe 29.1.2018. Më 19.1.2018 – grupi i punës shqyrtoj amendamentet në prezencë të deputetit Korab Sejdiu, dhe në të njëjtën ditë takoj odat ekonomike për të diskutuar lidhur me amendamentin e deputetes Mimoza Kusari – Lila, në prezencë të deputetes. Deputeti Korab Sejdiu, ka parashtruar 23 amendamente; ka hequr dorë vetëm nga amendamenti i tij nr.13, ndërsa Amendamentet 2; 6; 11 dhe 12 për shkak të riformulimit janë shndërruar në amendamente të Komisionit, po ashtu, deputetit iu ka ndryshuar terminologjia teknike e amendamenteve, pa cenuar përmbajtjen e tyre, për të cilën është njoftuar deputeti. Deputetja Mimoza Kusari – Lila, nuk është tërhequr nga Amendamenti i saj. Grupi i punës, ka kërkuar nga odat ekonomike dhe asociacionet e tjera të biznesit që të japin një opinion lidhur më amendamentin e deputetes më 19.1.2018, si dhe nga MTI-ja si sponsorizues i projektligjit. MTI-ja me shkrim është deklaruar së është kundër këtij amendamenti; po ashtu, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda e Afarizmit dhe Shoqata e Bankave janë deklaruar kundër amendamentit të deputetes Kusari – Lila. Ajo tha se raporti përmban në tërësi 26 amendamente dhe kërkoi që vetëm amendamenti 11, të bëhet pa përkrahje të komisionit, e jo siç është më përkrahje.

Pas debatit, komisioni, unanimisht nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë tregtare procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës.

Raporti me Amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.

**8. Të ndryshme.
Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA**



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
Komisioni për Buxhet dhe Financa;
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë tregtare;

Datë: 30.1.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 30.1.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë tregtare dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Në preambulë të projektligjit, pas fjalës “Miraton” shtohet “Tabela e Ligjit”.

Amendamenti 2

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Titulli i projektligjit “Ligji për shoqëri tregtare”, zëvendësohet me “Ligji për ndërmarrje afariste”, respektivisht termi “Shoqëri Tregtare” në tërë projektligjin zëvendësohet me termin “Ndërmarrje Afariste”.

Amendamenti 3

Neni 1, në paragrafin 2, fjala “plotësisht” zëvendësohet me “pjesërisht”, dhe paragrafit “3” i hiqet teksti “Ky ligj është pjesërisht në përputhje me” dhe behët nënparagrafi “2.7” i paragrafit “2”.

Amendamenti 4

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 3, nën-nenparagrafi 1.3.2 fshihet fjala “ose” dhe pikëpresja zëvendësohet me pikë.

Amendamenti 5

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 3, nënparagrafi 1.7. riformulohet si në vijim:

1.7. “Gjykata” për të gjitha çështjet të cilave baza juridike iu buron nga ky ligj, do të thotë Departamenti për Çështjet Ekonomike i Gjykatës Themelore të Prishtinës, përfshirë cilën do gjykatë ose department pasues të këtij departamenti, përveq nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj ose ndonjë ligj tjetër.

Amendamenti 6

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 3, nënparagrafi 1.8. pas fjalës “pagan” dhe para fjalëve “një ortakërie ose një Korporate ” shtohen fjalët “ose i jep”.

Amedamenti 7

Neni 15, ndryshohet si në vijim:

Neni 15

Regjistri i Ndërmarrjeve afariste

1. Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta fizike dhe elektronike për secilën Shoqëri Tregtare dhe subjekt tjetër që ka detyrimin e regjistrimit, siç është përcaktuar në këtë ligj.
2. Regjistri mbahet në format fizik dhe elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga ARBK në format fizik dhe elektronik në dosjen e Shoqërisë Tregtare në Regjistër.
3. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga ARBK në format fizik dhe në format elektronik.
4. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në Regjistër, kryhen nëpërmjet sistemit elektronik por duhet të jenë të arkivuara edhe në forme fizike.
5. Regjistri i Shoqërive Tregtare është regjistër fizik dhe elektronik i cili mirëmbahet nga ARBK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave publik dhe sigurimin e integritetit të të dhënave.
6. ARBK obligohet që të bashkëpunojë rregullisht me organet e tjera të administratës shtetërore për të siguruar përditësimin e rregullt të informatave të përfshira në Regjistër dhe të gjitha organet e administratës shtetërore janë të obliguara t'i dorëzojnë ARBK-së informatat që nevojiten për përditësimin e regjistrit, në pajtim me ligjin në fuqi.

Amendamenti 8

Neni 17, paragrafi 12 të zëvendësohet si në vijim:

12. Aplikimet dhe dokumentet e dorëzuara në ARBK, duke përfshirë aplikimet për bartjen e historikut nga një formë e Shoqërisë Tregtare në tjetrën, përpunohen në pajtim me procedurën për regjistrim të përcaktuar nga Ministria, përmes një akti nënligjor të miratuar në pajtim me këtë ligj.

Amendamenti 9

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 21, paragrafi 3, fjalia “ARBK bën hulumtimet e duhura” zëvendësohet me “ARBK bën kërkimet e duhura”.

Amendamenti 10

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 24, paragrafi 3, pas nënparagrafit 3.4. shtohet një nënparagrafi i ri 3.5 me tekstin si në vijim:

“3.5. Ortakëritë dhe Korporatat mund të kenë edhe përfaqësues të tjerë të autorizuar përveç atyre të përmendur në këtë dispozitë, nëse ashtu parashihet me Marrëveshje të Ortakërisë ose Statut.”.

Amendamenti 11

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Neni 24, paragrafit 5, në fund të tekstit të tij, i shtohet edhe teksti:

“Në rast të dorëheqjes nga Personi i Autorizuar nga kjo pozitë, Personi i Autorizuar mund të kërkojë nga ARBK për të bërë ndryshimet përkatëse në Regjister, nëse dorëzon në ARBK dokumentin e dorëheqjes dhe dëshminë që ka njoftuar organin kompetent të Shoqërisë Tregtare për dorëheqjen.”

Amendamenti 12

Amendament i deputetës Mimoza Kusari – Lila, pa përkrahjen të Komisionit funksional

Neni 34, nënparagrafit 2.5., i shtohen nën-nënparagrafet, e ri si në vijim:

2.5.1 numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të shoqërisë aksionare duhet të përmbajë edhe kuoten prej 40% pjesëmarrje të grave në Bord;

2.5.2 zbatimi i kësaj kuote duhet të filloj jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit të Ligjit;

2.5.3. pas dy viteve të zbatimit të ligjit, kuota gjinore fillon aplikimin e saj në 50%.

2.5.4 sanksionet për mospërfillje të kësaj kuote, do të përcaktohen me akte nënligjore të cilat burojnë nga ky ligj.

Amendamenti 13

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 45, pas paragrafit 6, shtohet një paragraf i ri 7, me tekstin si në vijim:

“ 7. Me përfundimin e procedurave të parapara për çregjistrimin e Shoqërisë Tregtare apo subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në ARBK, ARBK i lëshon palës apo palëve një Vendim për Çregjistrim.”

Amendamenti 14

Neni 80, ndryshohet si vijon:

1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të ketë për aksionarë një ose më shumë persona fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare. Organizat joqeveritare nuk mund të jenë aksionar në Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara.

2. Drejtori(ët) Menaxhues mbajnë një listë të Aksionarëve që përmban emrat, adresat dhe vlerën nominale të aksioneve të tyre, ose përqindjen e aksioneve të mbajtura si dhe datën në të cilën janë bërë aksionarë.

Amendamenti 15

Neni 83, nën-nënparagrafi 1.6.4 riformulohet si në vijim:

1.6.4. kur auditimi është i obligueshem sipas legjislacionit në fuqi, ose kur auditimi behët mënyrë vullnetare.”.

Amendamenti 16

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Neni 83, pas nën –nënparagrafit 1.6.4, shtohët një nën-nënparagraf i ri 1.6.5, me tekstin si në vijim:

“ 1.6.5. Dokumentet e listuara në nenin 83, pika 1.6, mund të mbahen edhe në adresën e personit ose subjektit përgjegjës për çështjet financiare dhe/ose të kontabilitetit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.”.

Amendamenti 17

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 100, në nën-nënparagrafet 4.1.1 dhe 4.1.1 fjala “kërkesë” zëvendësohet me fjalën “padi”.

Amendamenti 18

Neni 124, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

2. Organizat joqeveritare nuk mund të jenë aksionarë në shoqëri aksionare.

Amendamenti 19

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Neni 150, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

“1. Bordi i Drejtorëve i Shoqërisë Aksionare, nëse është i autorizuar në bazë të statutit ose me vendim të aksionarëve, mund të deklarojë dhe paguajë dividendë në aksionet e Shoqërisë Aksionare. Në rast të një vendimi të tillë, dividendat duhet të paguhet në të gjitha aksionet e

emetuara të çfarëdo lloji ose kategorie, dhe në asnjë rrethanë nuk mund të deklarohet dhe paguhet vetëm ndaj disa aksioneve. Bordi i Drejtorëve ka të drejtë të ndërmarrë këtë veprim në çdo kohë.”.

Amendamenti 20

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

PJESA E NËNTË, titulli “SHËNDËRRIMI I KORPORATAVE” zëvendësohet me “SHNDËRRIMI I NDËRMARRJEVE AFARISTE”

Dhe Nenit 253, paragrafit 1, në fund të tekstit, shtohet edhe teksti si në vijim:

“Një Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme ose Oratkëri e Kufizuar mund të shndërrohet në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri Aksionare, siç parashihet në Pjesën e Nëntë të këtij ligji.”.

Amendamenti 21

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Nenit 253, nënparagrafi 2.1. riformulohet si në vijim:

2.1. “Shoqëria Tregtare në Shndërrim” nënkupton një Korporatë, Biznes Individual, Ortakëri të Përgjithshme, ose Ortakëri të Kufizuar që shndërron formën e tij sipas Pjesës së Nëntë të këtij ligji; dhe”. Dhe termi “Korporatë në shndërrim” zëvendësohet në tërë projektligjin me termin “Shoqëri Tregtare në shndërrim”.

Amendamenti 22

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Neni 254, pas nënparagrafit 1.2. shtohet nënparagrafi i ri 1.3. me tekstin si në vijim:

“ 1.3. Nëse Shoqëria Tregtare në Transformim është një Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, ose Ortakëri e Kufizuar, shndërrimi dhe plani i shndërrimit duhet të miratohet në përputhje me procedurat e vendimmarjes përkatëse të parapara me këtë projektligj ose dokumentet themeltare të këtyre Shoqërive Tregtare.”.

Amendamenti 23

Amendament i deputetit Korab Sejdiu me përkrahje të Komisionit funksional

Neni 255, nënparagrafi 1.3. pas fjalës “aksioneve” dhe para fjalëve “të Korporatës në shndërrim” shtohen fjalët “ose Kuotave”.

Amendamenti 24

Amendament i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahje të Komisionit funksional

Nenit 257, pas nënparagrafit 1.2. shtohet nënparagrafi i ri shtohet nënparagrafi 3, si në vijim:

“3. Përveq si është paraparë në këtë Nen si më sipër, në rastet kur Shoqëria Tregtare në Transformim është një Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, ose Ortakëri e Kufizuar, shndërrimi në Korporatë në asnjë rrethanë nuk kufizon përgjegjësinë e pakufizuar personale të pronarëve të këtyre shoqërive tregtare për detyrimet e shoqërive tregtare përkatëse të krijuara

deri në momentin e shëndërrimit. Pas transformimit, për detyrimet e këtyre shoqërive tregtare që janë krijuar para transformimit, kreditorët mund të kërkojnë përgjegjësi nga Korporata e mbijetuar dhe nga pronarët ekzistues të këtyre shoqërive tregtare në shndërrim, por jo edhe nga pronarët që mund të shtohen pas shndërrimit.”

Amendamenti 25

Neni 266, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri si në vijim:

“4. Gjatë periudhës tranzitore tre (3) vjeçare, ARBK obligohet të pajisë të gjitha Shoqëritë Tregtare ekzistuese me numër unik.”

Amendamenti 26

Në tërë tekstin e projektligjit të behën këto përmirësime teknike, si në vijim:

- Fjalët brenda titujve të neneve 46, 66, 227, 229, 233, 235, 236, 238, 239, 240, 242, 248, 250, 254, 256, 263 të fillojnë gjithnjë me shkronja të mëdha sikurse në pjesën tjetër të Projektligjit.
- Neni 80, paragrafi 1, fjala “veçant” të zëvendësohet me “veçantë”
- Titulli i Nenit 116, fjala “Njoftimi” të zëvendësohet me “Njoftimit”
- Neni 124, paragrafi 2, fjala “veçant” të zëvendësohet me “veçantë”
- Titulli i Nenit 148, fjalët “(revers-splits)” të zëvendësohen me “(reverse-splits)”
- Titulli i Nenit 151, fjala “Dividendeve” të zëvendësohet me “Dividendëve”
- Titulli i Nenit 156, fjala “Dividendave” të zëvendësohet me “Dividendëve”
- Titulli i Nenit 157, fjala “Dividendave” të zëvendësohet me “Dividendëve”
- Titulli i Nenit 202, fjala “Article” të zëvendësohet me “Neni”
- Titulli i Kapitullit XI Kontrollimi i Aksioneve të Shoqërisë Aksionare të zëvendësohet me si vijon: KAPITULLI XII KONTROLLIMI I AKSIONEVE TË SHOQËRISË AKSIONARE
- Titulli i Kapitullit XII Shpërbërja e Shoqërisë Aksionare dhe Vendimi për Inicimin e Procedurës Falimentimit të zëvendësohet me si vijon: KAPITULLI XIII SHPËRBËRJA E SHOQËRISË AKSIONARE DHE VENDIMI PËR INICIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT
- Titulli i Nenit 214 të zëvendësohet fjala “Njoftimi” me “Njoftimit”
- Titulli i Nenit 231 të zëvendësohet fjala “Bashkimi” me “Bashkimin”
- Titulli i Nenit 249 të zëvendësohet fjala “zyrtari” me “Zyrtar i”
- Titulli i Nenit 255 të zëvendësohet fjala “Shndërrimit” me “Shndërrimit”

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA